



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 814/4 Prot.

Durrës, më 29.4.2022

VENDIM

Nr 40, datë 29.4 2022

**"PËR MIRATIMIN PARAPRAK TË REDUKTIMIT TË TARIFËS SË PROGRAMIT
TË STUDIMIT DOKTORATË NË "SHKENCA EKONOMIKE"
NË FAKULTETIN E BIZNESIT NË UNIVERSITETIN "ALEKSANDER MOISIU"
DURRËS**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 685 datë 25.08.2010 "Për riorganizimin e Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës", të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", të Statutit të Universitetit, të Rregullores së Universitetit, të vendimit të Rektoratit nr.6 datë 06.04.2022 Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 29.04.2022.

V E N D O S I :

1. Të propozojë reduktimin e tarifës vjetore të studimit në masën 70% për studentët doktorantë të cilët janë pjesë e stafit akademik në UAMD dhe do të vazhdojnë programin të studimit Doktoratë në "Shkenca Ekonomike" pranë Fakultetit të Biznesit. Ky reduktim do të përfitohet në bazë të nënshkrimit të një marrëveshje mes studentit doktorant dhe UAMD ku do të përcaktohet se, pas përfundimit të studimeve do të jetë për një periudhë 3 vjeçare pjesë e stafit akademik me kohë të plotë në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës.
2. Në rast mospranimi apo shkelje të kësaj marrëveshje studentit doktorant i lind detyrimi për pagesën e plotë të tarifës vjetore të shkollimit.
3. Ky propozim i kalon për miratim Bordit të Administrimit.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Ksënela SOTIROFSKI

